VENDIM
Nr. 510, datë 25.9.2025

PËR PËRCAKTIMIN E FUSHËS SË PËRGJEGJËSISË SHTETËRORE TË MINISTRISË PËR EVROPËN DHE PUNËT E JASHTME

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 5, të ligjit nr. 90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore", me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e misionit dhe të fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, sipas përcaktimeve të këtij vendimi.

2. Misioni i Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme është hartimi dhe zbatimi i politikës së jashtme të Republikës së Shqipërisë në raport me shtetet e tjera, organizatat ndërkombëtare, si dhe subjektet e tjera të së drejtës ndërkombëtare, drejtimi politik i procesit të integrimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian dhe zhvillimi i dialogut politik me institucionet e Bashkimit Evropian, zhvillimi dhe fuqizimi i diplomacisë ekonomike, si dhe mbrojtja e të drejtave të shtetasve shqiptarë dhe komuniteteve shqiptare jashtë vendit.

3. Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme ushtron veprimtarinë e saj në këto fusha përgjegjësie shtetërore:

a) harton, përpunon, organizon dhe zbaton politikën e jashtme të shtetit shqiptar;

b) realizon shprehjen dhe mbrojtjen e interesave të shtetit shqiptar, si dhe të drejtat dhe interesat e shtetasve shqiptarë në marrëdhëniet ndërkombëtare me shtetet e tjera dhe organizatat ndërkombëtare;

c) mbështet Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, Këshillin e Ministrave dhe Presidentin e Republikës së Shqipërisë në përcaktimin e qëndrimeve të rëndësishme lidhur me politikën e jashtme;

ç) bashkërendon veprimtarinë me jashtë të institucioneve qendrore dhe vendore;

d) mbron të drejtat dhe interesat e shtetasve shqiptarë dhe të drejtat kombëtare të popullsisë shqiptare që jeton jashtë kufijve të Republikës së Shqipërisë, si dhe organizon, harton e zbaton politikën shtetërore në interes të tyre, në bashkëpunimin me ministritë përgjegjëse;

dh) nxit dhe promovon zhvillimin e komunikimit dhe ndërveprimit të diasporës me shqiptarët jashtë kufijve, për të rritur dhe zhvilluar vlerat dhe traditat më të mira shqiptare;

e) promovon interesin ekonomik kombëtar në arenën ndërkombëtare, duke ndërmarrë aktivitete zyrtare diplomatike të fokusuara në rritjen e eksporteve, tërheqjen e investimeve të huaja dhe pjesëmarrjen në punë të organizatave ekonomike ndërkombëtare;

ë) drejton, bashkërendon dhe shpreh qëndrimet politike në emër të shtetit shqiptar për procesin e integrimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian, përfshirë nëpërmjet rrjetit të përfaqësive diplomatike pranë Bashkimit Evropian dhe në vendet anëtare të tij. Zhvillon dialogun politik, përfshirë lidhur me politikën e përbashkët të jashtme e të sigurisë, me institucionet e Bashkimit Evropian dhe vendet anëtare, në kuadrin e procesit të negociatave të aderimit dhe të procesit të stabilizimit dhe të asociimit;

f) ndjek procedurat për lidhjen e akteve ndërkombëtare, si dhe anëtarësimin e Republikës së Shqipërisë në organizatat ndërkombëtare, sipas legjislacionit në fuqi që rregullon marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë.

4. Vendimi nr. 81, datë 9.2.2022, i Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme", i ndryshuar, shfuqizohet.

5. Ngarkohet Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama